



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 685/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.10.2017 shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Toni-Security” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: “Shërbim Roje Private”, me nr. REF-25809-09-07-2017, me fond limit 2,658,332.93 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.09.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Glliozheni”.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Eurogjici-Security” sh.p.k. për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “TONI SECURITY” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Lidhja e Prizrenit”, L.8, P.10/1, Tiranë.

Operatori ekonomik “EUROGJICI SECURITY” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Adem Jashari”, L.8, H.10, Ap.3, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni”.
Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatorët ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatorët ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashut, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Operatorët ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1.Në datën 08.09.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me objekt: “*Shërbim Roje Private*”, me nr. REF-25809-09-07-2017, me fond limit 2,658,332.93 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.09.2017, nga autoriteti kontraktor, *Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni”*.

II.2.Në datën 18.09.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3.Në datën 22.09.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.4.Në datën 26.09.2017 operatorët ekonomik ankimues “Toni-Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k, kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së, për skualifikimin e ofertave të tyre.

II.5.Nga shqyrtimi i materialeve të administrurara në dosjet e shqyrtimit administrativ të procedurës objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesat dhe i ka kthyer pergjigje operatorëve ekonomik ankimues në datën 27.09.2017, duke mos i pranuar ato.

II.6.Në datën 04.10.2017 operatorët ekonomik ankimues “Toni-Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k kanë paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesat e paraqitura pranë autoritetit kontraktor.

II.7.Në datën 13.09.2017, operatori ekonomik ankimues “BALILI-KO” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.8.Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “BALILI-KO” sh.p.k., në përfundim të shqyrtimit administrativ me objekt “Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me objekt: “*Shërbim Roje Private*”, me nr. REF-25809-09-07-2017, me fond limit 2,658,332.93 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.09.2017, nga autoriteti kontraktor, *Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni”*”, Komisioni i prokurimit Publik, me anë të vendimit KPP 682/2017, datë 04.10.2017 vendosi si më poshtë vijon:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik „BALILI-KO” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: “Shërbim Roje Private”, me nr. REF-25809-09-07-2017, me fond limit 2,658,332.93 lekë (pa*

TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 18.09.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koco Gliozheni".

2. Autoriteti kontraktor të anullopë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Në rishpalljen e procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "BALILI-KO" sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur këtyre ankesave

Arsyeton

III.1. Në datën 08.09.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit "Kërkesë për Propozime", me objekt: "Shërbim Roje Private", me nr. REF-25809-09-07-2017, me fond limit 2,658,332.93 lekë (pa TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 18.09.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koco Gliozheni".

III.2. Në datën 18.09.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.3. Në datën 22.09.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.4. Në datën 26.09.2017 operatorët ekonomik ankimues "Toni-Security" sh.p.k. dhe "Eurogjici-Security" sh.p.k, kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së, për skualifikimin e ofertave të tyre.

III.5. Nga shqyrtimi i materialeve të administurara në dosjet e shqyrtimit administrativ të procedurës objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesat dhe i ka kthyer përgjigje operatorëve ekonomik ankimues në datën 27.09.2017, duke mos i pranuar ato.

III.6.Në datën 04.10.2017 operatorët ekonomik ankimues “Toni-Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k kanë paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesat e paraqitura pranë autoritetit kontraktor.

III.7.Në datën 13.09.2017, operatori ekonomik ankimues “BALILI-KO” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.8.Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “BALILI-KO” sh.p.k., në përfundim të shqyrtimit administrativ me objekt “Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: “Shërbim Roje Private”, me nr. REF-25809-09-07-2017, me fond limit 2,658,332.93 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.09.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni”, Komisioni i prokurimit Publik, me anë të vendimit KPP 682/2017, datë 04.10.2017 vendosi si më poshtë vijon:

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik „BALILI-KO” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: “Shërbim Roje Private”, me nr. REF-25809-09-07-2017, me fond limit 2,658,332.93 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.09.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni”.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Në rishpalljen e procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “BALILI-KO” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.9.Në këto kushte, bazuar në faktin që procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: “Shërbim Roje Private”, me nr. REF-25809-09-07-2017, me fond limit 2,658,332.93 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.09.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni”, e cila është edhe objekt i ankesave të operatorëve ekonomik ankimues “Toni-Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k, tashmë është anuluar nga Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit KPP 682/2017, datë 04.10.2017, KPP gjykon se marrja në shqyrtim e këtyre ankesave nuk do të sillte asnjë pasojë juridike, për shkak se objekti i tyre nuk egziston më. Vlen të theksohet se anulimi i një procedure prokurimi sjellë automatikisht pavlefshmërinë e të gjitha veprimeve juridike të autoritetit kontraktor lidhur me këtë procedurë.

Sa më sipër, ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomik ankimues “Toni-Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k, nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomik “Toni-Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me objekt “Shërbim Roje Private”, me nr. REF-25809-09-07-2017, me fond limit 2,658,332.93 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.09.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni”.
2. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomik ankimues “Toni-Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici-Security” sh.p.k
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1550 Protokoli, Datë 04.10.2017; Nr. 1551 Protokoli, Datë 04.10.2017

Public Health Sector

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha